



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 353/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Dardanë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Dardanë, për shkak të vendosjes së posterave mbi shenja publike të trafikut, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Dardanë, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Dardanë, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 1450 (njëmijekatërqindpesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 28.10.2013, nga LVV, me të cilën pretendohet se me datën 26.10.2013, në rrugën për në fshatin Kopernicë, Komuna Dardanë, anëtarë të subjektit politik PDK, kanë vendosur posterë të kandidatit nga ky subjekt, Begzad Sinani, mbi shenja të komunikacionit. Parashtruesi i ankesës me këtë rast konsideron se është bërë shkelje e Nenit 33 pika b) e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme LZP, dhe neni 4.1 pika b) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës foto në cilësinë e provës.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të Nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 28.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik, dhe ka kërkuar të përgjigjet ndaj ankesës deri me datë 29.10.2013, brenda afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen në ankesë nga subjekti politik PDK, në të cilën theksohet se pretendimet e LVV, janë të pabaza, lidhur me shkeljen e rregullave të përcaktuara në nenin 33 pika b të LZP-së, ndërsa sipas të dhënave të cilat i kanë, persona të paidentifikuar kanë vendosur posterët e kandidatit për kryetar të komunës së Dardanës, Begzad Sinani, në anën e prapme të shenjave të komunikacionit, me qëllim të dëmtimit të PDK-së, mirëpo edhe përkundër kësaj, me të të kuptuar këtë aktivistët tanë kanë hequr këta flamuj nga vendet për të cilët është ankuar LVV, thuhet në përgjigjen në ankesë nga subjekti politik PDK.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Në fotografitë e bashkangjitura si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterit i kandidatit të subjektit politik PDK, Begzad Sinani, është i vendosur mbi shenjën publike të trafikut gjë që është në kundërshtim me nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore

publike të trafikut gjë që është në kundërshtim me nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe neni 33 pika b) të LZP-së të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që ndalojnë vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në shenja publike të trafikut.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se, subjekti politik PDK, meqëse ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe lidhur me faktin se posterit i kandidatit të PDK-së, ka qenë i vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e posterave si dhe poashtu subjekti i njëjtë politik ka bërë shkelje të njëjtës natyre edhe më parë në këto zgjedhje. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se subjekti politik PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes, duke i larguar menjëherë posterin nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

PZAP-i, duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstatoi se subjekti politik PDK-ka rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, pasi që posterit i kandidatit nga ky subjekt, është i vendosur në shenja publike të trafikut, i cili veprim është ndaluar me dispozitat e cituara më lart, ndërsa duke marrë parasysh se subjekti politik PDK, ka ndërmarr veprime të menjëhershme për evitimin e shkeljes së supozuar, si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara siç shihet nga fotot si provë të bashkangjitura përgjigjes në ankesë, veprim i cili ka ndikuar në lartësinë e gjobës, andaj në kuptim të, nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 353/2013 më datën 31.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*